

NOTË INFORMUESE

Tiranë, më 11.05.2023

Mbi kërkesën e ILD për procedim disiplinor me masën “Ulje page deri në 40% për një periudhë deri në 1 vit” për gjyqtarin B.M. dhe “Vërejtje publike” për gjyqtarin R.A.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përfunduar hetimin disiplinor për zvarritje gjykimi mbi 2 vjet, ndaj gjyqtarëve I.M., B.M., Z.Sh., R.A., M. Ç. dhe Z.V., pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në kohën e shkeljes së pretenduar, hetim ky i nisur nga ish Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë në mars 2017, bazuar në informacionin e kryetarit të gjykatës Elbasan për muajin Dhjetor 2016, dosje e transferuar për trajtim pranë ILD-së në shkurt 2021. Në kushtet kur ka rezultuar se kryesisht nuk ekzistojnë elementë të shkeljes disiplinore, hetimi disiplinor i nisur është mbyllur për magjistratët I.M., Z.Sh., M. Ç. dhe Z.V., gjyqtarë pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në kohën e shkeljes së pretenduar, ndërsa për gjyqtarët B.M. dhe R.A. është vendosur fillimi i procedimit disiplinor, respektivisht për çështjet gjyqësore civile që datojnë të regjistruara në gjykatë më 23.07.2009 dhe më datë-24.09.2014.

Në përfundim të hetimit disiplinor të kryer, ILD i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor me kërkesën për procedim disiplinor ndaj magjistratëve B.M. dhe R.A., me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1 shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja “c” neni 107 dhe neni 108 i ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin”, për gjyqtarin B.M. është kërkuar caktimi i masës disiplinore “*Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë jo më të gjatë se një vit*”, ndërsa për gjyqtarin R.A. është kërkuar caktimi i masës disiplinore “*Vërejtje publike*”.

Në seancën dëgjimore të thirrur nga KLGJ më 12.03.2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka parashtruar situatën sipas të cilës, në kuadër të procedimit disiplinor ndaj ish-gjyqtarëve B.M. dhe R.A., Këshilli i Lartë Gjyqësor kishte vendosur fillimisht pezullimin e procedimit deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar.

Më pas, Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA) la në fuqi vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) për shkarkimin nga detyra të të dy magjistratëve. Për rrjedhojë, sipas Kushtetutës dhe ligjit për rivlerësimin, shkarkimi pati efekt të menjëhershëm dhe të dy humbën statusin e magjistratit. Meqenëse B.M. dhe R.A., nuk e gëzojnë më statusin e magjistratit, ata nuk janë më subjekte mbi të cilët KLGJ mund të ushtrojë kompetencat e tij disiplinore.

Për këtë arsye, duke iu referuar edhe nenit 95 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas të cilit procedura përfundon pa vendim përfundimtar kur objekti ose qëllimi i saj është bërë i pamundur, kërkohet që KLGJ-ja: *të përfundojë procedimin disiplinor ndaj ish-gjyqtarëve B.M. dhe R.A., pa marrë një vendim përfundimtar mbi përgjegjësinë disiplinore.*